REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 25/9 Prot.

Pogradec, më 25.09.2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë _____._____.2026

"PËR DHËNIEN E MENDIMIT PRO/KUNDËR MBI PROPOZIMIN PËR NDARJEN ADMINISTRATIVE- TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Këshilli i bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të sotme pasi shqyrtoi propozimin për riorganizimin administrativo-territorial dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, mendimet e paraqitura gjatë procesit të konsultimit dhe interesat e komuniteteve vendore të prekura, mështetur në nenin 108, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 86 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 87, shkronja "b", të ligjit nr. 139/2015, nenin 89 të ligjit nr. 139/2015, nenin 90, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 139/2015 dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak Pogradec , miratuar me Vendimin nr 40 datë 05.03.2020" Për miratimin e Rregullores të Këshillit Bashkiak Pogradec",

VENDOSI:

1. Shprehjen e mendimit zyrtar PRO/KUNDËR propozimit , në kuadër të riorganizimit administrativo-territorial të propozuar, sipas dokumentacionit të përcjellë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
2. Të vlerësojë se zbatimi i riorganizimit duhet të garantojë vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve publike për banorët e territorit aktual të Bashkisë Pogradec , aksesin e tyre në administratën vendore dhe përfaqësimin e përshtatshëm të interesave të komuniteteve të përfshira.
3. Opinionet e këshilltarëve janë pjesë përbërëse e këtij vendimi, bashkëlidhur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 21/09/2026 **Ora** : 10 :30 Vendi: Njësia Administrative Dardhas

Vendi: Shkolla Dardhas

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 11 persona të pranishëm .

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Reforma Administrativo Territoriale"

Pjesëmarrës :

Manjola Kamolli (Kryetare e Këshillit Bashkiak)

Klajdi Gjona (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Vjollca Pllaha (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit Bashkiak)

M. Kamolli: Ju kemi mbledhur sot për të diskutuar në lidhje me reformën territorial. Ne I dimë shqetësimet, problematikat, I kemi dëgjuar diskutimet që janë bërë kohët e fundit. Na është kërkuar që të shprehemi me një vendim si Këshill Bashkiak në lidhje me ndarjen e re Administrativo- Territoriale, pavarësisht se ne nuk na prekin ndryshimet. Reforma e re propozon të kalojë nga 61 Bashki që ka aktualisht në 46 Bashki. Skema aktuale e funksionimit të Bashkive është Bashki-Njësi Administrative, ndërsa me propozimin e ri do jetë Bashki-Qytet-Njësi Administrative, ku cdo qytet do të ketë një Nënkryetar I cili do të jetë përgjegjës për koordinimin administrative.

Aktet nënligjore nuk kanë dalë akoma që të kemi informacion si do të funksionojë. Ne kemi ardhur të dëgjojmë mendimet tuaja dhe ti përcjellim.

E. Shkullaku: Investimet janë larguar .

K.Gjona: Cfarë kompetenca do të ketë administrator?

M.Kamolli: Ndaj them që është e rëndësishme të dalin aktet nënligjore.

Unë personalidht kam sygjeruar që të përcaktohet nga një buxhet specific për secilën Njësi Administrative.

E.Shkullaku: Shërbimet janë por nuk ka investime.

Astrit Hamolli: Jemi mirë që qëndrojmë si Bashki, kjo është më e rëndësishme.

Erton Mucka: Administratori duhet të ketë më shumë kompetenca , gjithashtu dhe kryetari I fshatit.

E. Shkullaku: Njësitë Administrative nuk kanë marrë fare investime.

Ju falemenderit! Nqs nuk keni dicka tjetër për të diskutuar e mbyllim këtu.

Mbajti Procesverbalin: Sekretare e Këshillit
Jona BOJKO

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 21/09/2026 **Ora** : 12 :00 Vendi: Njësia Administrative Cërravë.

Vendi: Shkolla 9 Vjevare.

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 14 persona të pranishëm .

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Reforma Administrativo Territoriale"

Pjesëmarrës :

Manjola Kamolli (Kryetare e Këshillit Bashkiak)

Klajdi Gjona (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Vjollca Pllaha (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit Bashkiak)

M. Kamolli: Ju kemi mbledhur sot për të diskutuar në lidhje me reformën territorial. Ne I dimë shqetësimet, problematikat, I kemi dëgjuar diskutimet që janë bërë kohët e fundit. Na është kërkuar që të shprehemi me një vendim si Këshill Bashkiak në lidhje me ndarjen e re Administrativo- Territoriale, pavarësisht se ne nuk na prekin ndryshimet. Reforma e re propozon të kalojë nga 61 Bashki që ka aktualisht në 46 Bashki. Skema aktuale e funksionimit të Bashkive është Bashki-Njësi Administrative, ndërsa me propozimin e ri do jetë Bashki-Qytet-Njësi Administrative, ku cdo qytet do të ketë një Nënkryetar I cili do të jetë përgjegjës për koordinimin administrative. Aktet nënligjore nuk kanë dalë akoma që të kemi informacion si do të funksionojë. Ne kemi ardhur të dëgjojmë mendimet tuaja dhe ti përcjellim.

Kryetari I fshatit Leshnicë: Unë përcjell mendimin e banorëve të fshatit Leshnicë. Ata janë të pakënaqur me këtë mënyrë,ne kërkojmë që të rikthehet komuna sepse kishim më shumë shërbime, problemet zgjidhesin më shpejt. Tani nuk na dëgjohet fjala fare.

M.Kamolli: Ekspertet shprehen se shërbimi do të merret më shpejt dhe në mënyrë më efektive.

Azbi Bazelli: Duhet të përcaktohet buxhet për secilën Njësi Administrative.

Kryetar I fshatit Leshnicë; Fondet që ka Njësia Administrative ti menaxhojë administrator sepse mendoj që do të përdoret konkretisht për problemet e fshatit.

Olger Ibi: Mjafton që Bashkia të ketë në dispozicion mjetet.

Z.Dëfrim: Oshe ka bërë gabim ndarjet sepse Njësinë tonë e kap stacioni I Maliqit dhe për çdo shqetësim duhet të drejtohemi atje.

M.Hymetllari: Nuk mendoj se duhet të ketë më shumë kompetenca kryeplaku.

K.Kaftirani: Një pjesë e financave të paktën për emergjencat te administrohen nga asministratori.

Ju falemenderit! Nqs nuk keni dicka tjetër për të diskutuar e mbyllim këtu.

Mbajti Procesverbalin: Sekretare e Këshillit
Jona BOJKO

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 22/09/2026 **Ora** 10 :30 Vendi: Njësia Administrative Bucimas .

Vendi: Njësia Administrative Bucimas

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 14 persona të pranishëm .

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Reforma Administrativo Territoriale"

Pjesëmarrës :

Miranda Olldashi (Nën/kryetare e Këshillit Bashkiak)

Alketa Beka (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Ëngjëll Shyti (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Vjollca Pllaha (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

J.Bojko: Në adresën e Këshillit është depozituar një shkresë nga Kuvendi për Ndarjen e Re Administrativo Territoriale ku I kërkon të gjithë Këshillave Bashkiakë të dalin me një vendim në lidhje me këtë reform. Për këtë arsye në bazë të ligjit 139/2015 dhe Rregullores së Konsultimeve Publike, ne po shkojmë në cdo Njësi Administrative për të marrë mendimin e banorëve. Reforma e re propozon të kalojë nga 61 Bashki që ka aktualisht në 46 Bashki. Skema aktuale e funksionimit të Bashkive është Bashki-Njësi Administrative, ndërsa me propozimin e ri do jetë Bashki-Qytet-Njësi Administrative, ku cdo qytet do të ketë një Nënkryetar I cili do të jetë përgjegjës për koordinimin administrative. Po ja u jap fjalën ju për cdo mendim apo sygjerim të keni në lidhje me këtë reformë.

Seladin Capo (Kryetar I fshatit Gështenjas): Nuk funksionon kështu, nuk marrim përgjigje nga drejtoritë në Bashki, duhet të ketë një bashkëpunim me Bashkinë.

Kryetari I fshatit Guras: Njësia Administrative Bucimas është njësi e madhe, ka një mungesë koordinimi nga Bashkia. Njësia Administrative duhet të ketë më shumë kompetenca.

A.Beka: Ne sot jemi për ndarjen administrative. Fatmirësisht nuk do të prekeni. Administratori është ura lidhëse midis komunitetit dhe administratës.

Banor; Jemi të paqartë në lidhje me marrëdhënien administrative-territoriale. A do të forcohen kompetencat e tij, kapaciteti I punës ?

A.Beka: Buxheti I Bashkisë përbëhet nga granti I ardhur nga Qeveria dhe nga të ardhurat e veta, kjo është për tu parë sat ë ardhura sjell Njësia Administrative Bucimas dhe sa shërbime mer.

Aministratori : Ne kemi kërkuar fuqi punëtore sepse nuk mbulohet dot e gjithë njësia.

Ju falemenderit! Nqs nuk keni dicka tjetër për të diskutuar e mbyllim këtu.

Mbajti Procesverbalin: Sekretare e Këshillit
Jona BOJKO

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 22/09/2026 **Ora** 10 :30 Vendi: Njësia Administrative Udënisht .

Vendi: Njësia Administrative Udënisht.

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 16 persona të pranishëm .

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Reforma Administrativo Territoriale"

Pjesëmarrës :

Alketa Beka (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Ëngjëll Shyti (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Vjollca Pllaha (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit Bashkiak)

J.Bojko: Në adresën e Këshillit është depozituar një shkresë nga Kuvendi për Ndarjen e Re Administrativo Territoriale ku I kërkon të gjithë Këshillave Bashkiakë të dalin me një vendim në lidhje me këtë reform. Për këtë arsye në bazë të ligjit 139/2015 dhe Rregullores së Konsultimeve Publike, ne po shkojmë në cdo Njësi Administrative për të marrë mendimin e banorëve. Reforma e re propozon të kalojë nga 61 Bashki që ka aktualisht në 46 Bashki. Skema aktuale e funksionimit të Bashkive është Bashki-Njësi Administrative, ndërsa me propozimin e ri do jetë Bashki-Qytet-Njësi Administrative, ku cdo qytet do të ketë një Nënkryetar I cili do të jetë përgjegjës për koordinimin administrative. Po ja u jap fjalën ju për cdo mendim apo sygjerim të keni në lidhje me këtë reformë.

Kryetar I fshatit Mëmlisht: Kemi një mungesë të koordinimit në lidhje me Bashkinë. Drejtorët nuk kthejnë përgjigje në lidhje me kërkesat që bëjmë, nuk marrim shpërbimet që kërkojmë.

Arben Selko: Njësia jonë duhet të ketë më shumë kompetenca, mendoj se duhet të kemi një buxhet të vogël pë nevojat e fshatit.

Kryetar I fshatit Mëmlisht: Nevojat emergjente që kemi për llambat nuk I marrim dot kur na duhen, të jetë një buxhet I specifikuar për njësinë osë të jetnë mjetet e specfikuara.

Mbajti Procesverbalin: Sekretare e Këshillit
Jona BOJKO

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 23/09/2026 **Ora** 09 :30 Vendi: Njësia Administrative Trebinjë .

Vendi: Njësia Administrative Trebinjë.

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 9 persona të pranishëm .

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Reforma Administrativo Territoriale"

Pjesëmarrës :

Besnik Xhyra (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Klea Topa (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Ëngjëll Shyti (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit Bashkiak)

J.Bojko: Në adresën e Këshillit është depozituar një shkresë nga Kuvendi për Ndarjen e Re Administrativo Territoriale ku I kërkon të gjithë Këshillave Bashkiakë të dalin me një vendim në lidhje me këtë reform. Për këtë arsye në bazë të ligjit 139/2015 dhe Rregullores së Konsultimeve Publike, ne po shkojmë në cdo Njësi Administrative për të marrë mendimin e banorëve. Reforma e re propozon të kalojë nga 61 Bashki që ka aktualisht në 46 Bashki. Skema aktuale e funksionimit të Bashkive është Bashki-Njësi Administrative, ndërsa me propozimin e ri do jetë Bashki-Qytet-Njësi Administrative, ku cdo qytet do të ketë një Nënkryetar I cili do të jetë përgjegjës për koordinimin administrative. Po ja u jap fjalën ju për cdo mendim apo sygjerim të keni në lidhje me këtë reformë.

Kryetar I fshatit Trebinjë: Jemi shumë të kënaqur me këtë mënyrë administrimi

Ermal Tola: Bashkia të bjë një plan në lidhje me mjetet, ky është problem I vetëm që kemi.

Mbajti Procesverbalin: Sekretare e Këshillit
Jona BOJKO

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 23/09/2026 **Ora** 10 :00 Vendi: Njësia Administrative Proptisht .

Vendi: Njësia Administrative Proptisht.

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 16 persona të pranishëm .

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Reforma Administrativo Territoriale"

Pjesëmarrës :

Besnik Xhyra (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Klea Topa (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Ëngjëll Shyti (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit Bashkiak)

J.Bojko: Në adresën e Këshillit është depozituar një shkresë nga Kuvendi për Ndarjen e Re Administrativo Territoriale ku I kërkon të gjithë Këshillave Bashkiakë të dalin me një vendim në lidhje me këtë reform. Për këtë arsye në bazë të ligjit 139/2015 dhe Rregullores së Konsultimeve Publike, ne po shkojmë në cdo Njësi Administrative për të marrë mendimin e banorëve. Reforma e re propozon të kalojë nga 61 Bashki që ka aktualisht në 46 Bashki. Skema aktuale e funksionimit të Bashkive është Bashki-Njësi Administrative, ndërsa me propozimin e ri do jetë Bashki-Qytet-Njësi Administrative, ku cdo qytet do të ketë një Nënkryetar I cili do të jetë përgjegjës për koordinimin administrative. Po ja u jap fjalën ju për cdo mendim apo sygjerim të keni në lidhje me këtë reformë.

Hekuran Alia : Mendoj që të tre Njësitë e zonës së Mokrës të bëheshin në një njësi të vetme. Të kenë një buxhet për menaxhimin e brendshëm.

B.Xhyra: Unë personalisht mendoj që të kenë një buxhet më vete të parashikuar, në lidhje me fuqinë punëtore që ju duhej në bazë të nevojave.

S.Kume: Duhet të shtohet fuqia punëtore.

Mbajti Procesverbalin: Sekretare e Këshillit
Jona BOJKO

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 23/09/2026 **Ora** 12 :00 Vendi: Njësia Administrative Velcan .

Vendi: Njësia Administrative Velcan.

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 7 persona të pranishëm .

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Reforma Administrativo Territoriale"

Pjesëmarrës :

Besnik Xhyra (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Klea Topa (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Ëngjëll Shyti (Anëtar I Këshillit Bashkiak)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit Bashkiak)

J.Bojko: Në adresën e Këshillit është depozituar një shkresë nga Kuvendi për Ndarjen e Re Administrativo Territoriale ku I kërkon të gjithë Këshillave Bashkiakë të dalin me një vendim në lidhje me këtë reform. Për këtë arsye në bazë të ligjit 139/2015 dhe Rregullores së Konsultimeve Publike, ne po shkojmë në cdo Njësi Administrative për të marrë mendimin e banorëve. Reforma e re propozon të kalojë nga 61 Bashki që ka aktualisht në 46 Bashki. Skema aktuale e funksionimit të Bashkive është Bashki-Njësi Administrative, ndërsa me propozimin e ri do jetë Bashki-Qytet-Njësi Administrative, ku cdo qytet do të ketë një Nënkryetar I cili do të jetë përgjegjës për koordinimin administrative. Po ja u jap fjalën ju për cdo mendim apo sygjerim të keni në lidhje me këtë reformë.

Kryeplaku I fshatit Velcan: Duhet të ketë financim për Njësitë Administrative . Kaluam një situatë të vështirë gjjit verën dhe nuk na është përgjigjur asnjë në lidhje me kërkesat që kemi bërë.

Mbajti Procesverbalin: Sekretare e Këshillit
Jona BOJKO

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 25/09/2026 **Ora** : 12:00

Vendi: Salla e Këshillit

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 35 persona të pranishëm .

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"Reforma Administrativo Territoriale"

Pjesëmarrës :

Manjola Kamolli (Kryetare e Këshillit Bashkiak)

Ahmed Guxholli (Anëtar i Këshillit Bashkiak)

Zhaneta Elezi (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Vjollca Pllaha (Anëtare e Këshillit Bashkiak)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit Bashkiak)

Matilda Tollaku(Punonjese Sekratariati)

M. Kamolli: Ju kemi mbledhur sot për të diskutuar në lidhje me reformën territorial. Ne I dimë shqetësimet, problematikat, I kemi dëgjuar diskutimet që janë bërë kohët e fundit. Na është kërkuar që të shprehemi me një vendim si Këshill Bashkiak në lidhje me ndarjen e re Administrativo- Territoriale, pavarësisht se ne nuk na prekin ndryshimet. Reforma e re propozon të kalojë nga 61 Bashki që ka aktualisht në 46 Bashki. Skema aktuale e funksionimit të Bashkive është Bashki-Njësi Administrative, ndërsa me propozimin e ri do jetë Bashki-Qytet-Njësi Administrative, ku cdo qytet do të ketë një Nënkryetar I cili do të jetë përgjegjës për koordinimin administrative.

Aktet nënligjore nuk kanë dalë akoma që të kemi informacion si do të funksionojë. Ne kemi ardhur të dëgjojmë mendimet tuaja dhe t'i përcjellim ato.

Guri Bego: Njësitë administrative që janë ekzistuese nuk do të jene më?

Ky është një problem që e rregullojnë aktet nënligjore.Ndryshimet që parashikohen janë që një Bashki do te ketë disa qytete,të cilat do të funksionojnë nëpëermjet Nënkryetarve që do të jenë përcaktuar nga Kryetari I Bashkisë.

Guri Bego: Mokra është një problem më vete mendoj unë.Popullsia sa vjen e ulet ,ndërsa numri I punonjësve në njësit administrative është i njëjtë.

Nuk janë të nevojshëm mendoj.Ato të ardhura mund të përdoren diku tjetër.

M.Kamolli: Ndaj them që është e rëndësishme të dalin aktet nënligjore.

Guri Bego: Numri I punëtorve duhet të shkurtohet që të jetë më produktiv.

Edhe dicka tjeter që mendoj duhet të meret parasysh është,që në vendimmarje duhet të meret parasysh edhe dakortsia e partive të tjera.

M.Kamolli: BE kërkon të ketë më pak bashki dhe të këtë më shumë fonde.Jemi mirë që qëndrojmë si Bashki, kjo është më e rëndësishme.

Petraq Gjylameti: Administratori duhet të ketë më shumë kompetenca , gjithashtu dhe kryetari I fshatit.Shërbimet nuk janë në nivelin e duhur.

Administrata duhet te mari përgjegjësinë e saj ,duke qënë korrekt dhe të përgjegjshëm për punën që bëjnë .

Duhet të jenë më social me njerzit.

Në lagjen Kala ujrat e bardha nuk janë të sistemuara fare.Ka shumë problematika.Kalaja dhe Gorica kanë shumë problem.

M.Kamolli: Sygjerimet tuaja janë të rëndësishme dhe do t'ia përcillen Kuvendit.

Banori: Duhet të ketë pritje me popullin.

M.Kamolli: Edhe mua më është kërkuar opinion tim dhe e kam dhënë.E di që ka mbivendosje të shërbimeve.Banori I Alarupit duhet të shkoj në Maliq për të mbaruar punë.

Secili nga ne e shikon reformën të lidhyur me shërbimet.

Banori: Kur bëni konsultime ju lutem vendosni disa fletushka nëpër qëtet.

M.Kamolli: Ju falemenderit! Nqs nuk keni dicka tjetër për të diskutuar e mbyllim këtu.

Mbajti Procesverbalin: Matilda Tollaku